



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.777/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtare në Kuvend Komunal në Viti Dhurim Halabaku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.777/2021 i datës 04.11.2021 paraqitur nga kandidati për anëtare për Kuvend Komunal në Viti, Dhurim Halabaku nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Viti.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtare të Kuvendit Komunal në Viti Dhurim Halabaku nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Viti në të cilën pretendon se ka fakte të pamohueshme se votat e ti janë keqpërdorur dhe nuk figurojnë në emrat ku i ka dhënë votuesi. Si dëshmi ka bashkangjitur dokumentet e disa dëshmitarëve, familjarëve të tij gjithsej 15 dokumente. Duke qenë i bindur në parregullsi në procesin e votimit ka kërkuar nga PZAP që në Qendrat e Votimit 2607D/01R, 2615D/01D, të dërgohen në rinumërim për shkak se votat e familjarëve në këto qendra nuk figurojnë dhe si rezultat i saj është dëmtuar. Si dëshmi apelit i ka bashkangjitur letërnjoftimet dhe certifikatat e personave që e kanë votuar ndërsa në këto vendvotime i figurojnë 0 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se nga kandidati për Kuvend Komunal Dhurim Halabaku nga Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Viti, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi Qendrat e Votimit 2607D/01R, 2615D/01D, ndërsa pas kërtimeve të bera rezulton se i njëjti në 2607D/01R ka 5 vota të cilat supozonte se nuk i ka, po ashtu në kutin e votimit 2615D/01D ka 5 vota që bie ndesh me deklaratën e tij ku thoshte se nuk i ka nga 5 vota në këto qendra.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklaratat e dorëzuar për VV-të e vendosura në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në ato VV, po ashtu për Panelin është e qartë se në këto VV kandidati në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shkresore ankuesi në VV e vendosur në pikën -I- të dispozitivit nuk ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota se sa janë publikuar në rezultatit përfundimtar, prandaj u vendos si në pikën -I- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.777/2021 më datën 06.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.